

Data 02.06.2026

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – E Hapur - Shërbime – mbi kufirin e lartë monetar-
Prokurim me mjete elektronike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Supervizion punimesh Ndërtimi rruga lidhëse Tiranë-
Elbasan me korridorin VIII, Faza II”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): mbikëqyrje e
punës së ndërtimit, 71247000-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: 21,175,756.89 (njëzet e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë
mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e nëntë) **Lekë, pa TVSH**

Në Euro 222,131.09 (dyqind e njëzet e dy mijë e njëqind e tridhjetë e një presje zero nëntë)
Euro pa TVSH.

Në bazë të *Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:*

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 (*Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026*).

Bazuar në *Nenin 42, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar) “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”*. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte rrisje të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 56 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); dhe pikës 3 të nenit 24 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar)

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të bankës së Shqipërisë (Data 02.06.2026 ora 12:02:42).

1 Euro = 95.33 Lekë

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**shërbime të ngjashme**):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenin 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi përvojën e mëparshme të operatorit i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit. Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori i cili do të fitonte kontratën nuk

do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi.

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrijë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë. II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente: - Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë; - Kapacitetet financiare. **Duke qenë se pikat e licencës përfitohen si rezultat i eksperiencës dhe cilësisë, ato i përkasin vetë shoqërisë, dhe shfrytëzohen në harmoni me të gjithë komponentët që përbëjnë këtë shoqëri.**

Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriteret.

A)¹ **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi **pikët 50**

Propozimi Teknik **pikët 50**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Kriteret e Vlerësimit	Pikët
(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme	40-80%
---	---------------

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë	10-20%
--	---------------

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Certifikata e standardeve të cilësisë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronojnë edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar	[20-30]
--------------------------------------	----------------

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
---	----------

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	[30-40%]
---	----------

ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]
---------------------------	----------

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Metodologjia që ndiqet për realizimin e punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton gjithashtu detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve. Përmban menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit.*

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b- Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar)”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar)”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar)”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Shërbime -mbi kufirin e lartë monetar- prokurim me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41, të Ligjit nr. 10091/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **Ligjit Nr. 9/2025, datë 30.01.2025 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 26, datë 8.9.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 4, datë 4.2.2025), si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 61 të Ligjit Nr. 9/2025, datë 30.01.2025 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”,** citohet, si më poshtë:

1. “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

3.

4.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40 % të vlerës** së fondit të limit, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 41, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016”.* Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1	Punime gjërmimi në tokë
2	NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-11	Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
5	NP-12	Punime inxhinierike mjedisore
6	NS-1	Punime për prishjen e ndertimeve
7	NS-7	Barriera dhe mbrojtja rrugore
8	NS-9	Punime strukturore speciale

9	NS-18	Punime topogjeodezike
---	-------	-----------------------

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqënëse kemi të bëjmë me Mbikëqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se:

*Kategoritë e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit për objektin: “**Ndërtimi rruga lidhëse Tiranë-Elbasan me korridorin VIII, Faza II.** Gjithashtu, këto kategori licence bazohen edhe në projektin / Specifikimet teknike të punimeve të zbatimit për këtë objekt.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht **7 (shtatë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Prill 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin **Prill 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Prill 2026**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 41 pika 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: **për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës në preventivin “Supervizion punimesh Ndërtimi rruga lidhëse Tiranë-Elbasan me korridorin VIII, Faza II”.** Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë pëe muajin **Prill 2026** tregon besueshmëri për autoritetin.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi me licencë në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, ndjek e miraton cilësinë e punimeve për veprat e artit nga pikëpamja strukturore; miraton materialet dhe volumet e punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me ARRSH.

2. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë Inxhinier Topograf / Gjeodet me me licencë në mbikëqyrje, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piktetimet dhe kuotëzimin e objektit.

3. Mbikëqyrësin (Gjeolog), duhet të jetë Inxhinier Gjeolog me licencë në mbikëqyrje, i cili kontrollon bazamentin e punimeve të mbushjes, punimet gjatë gërmimit, hapjet dhe thellësinë e themeleve të veprave të artit.

4. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës e të sigurisë rrugore, i cili duhet të jetë Inxhinier Mekanik me licencë në mbikëqyrje. Ai miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

5. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë në mbikëqyrje.

6. Mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit, që duhet të jetë Inxhinier Hidroteknik me licencë në mbikëqyrje, i cili ndjek e miraton cilësinë e punimeve për drenazhimin e trupit dhe skarpateve të rrugës, veprave të vogla hidroteknike dhe vepra të mëdha (urë).

7. Mbikëqyrësin për punimet elektrike që duhet të jetë inxhinier elektrik me licencë në mbikëqyrje.

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.10, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për mbikëqyrje punimesh, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ Staf i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të Referencës, gjithashtu, argumentojme se zgjedhja e stafit të mbikëqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit: **“Ndërtimi rruga lidhëse Tiranë-Elbasan me korridorin VIII, Faza II**

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” ”(i ndryshuar), sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””(i ndryshuar), ku përcaktohet se:*

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Certifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikëqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve te ndërtimit”.

Termet e Referencës janë pjese e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.